



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

**EURALIUS**  
Consolidation of the  
Justice System in Albania

### Heqje dorë nga përgjegjësia:

Jeni të lutur të vini re se ky dokument përbën një përkthim dhe konsolidim jozyrtar të destinuar vetëm për qëllime informimi. Teksti nuk jep asnjë të drejtë dhe nuk imponon asnjë detyrim të ndryshëm nga çfarë parashikohet në legjislacionin e miratuar dhe të botuar në Fletoren Zyrtare. EURALIUS nuk garanton saktësinë dhe nuk mban përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit të mëposhtëm.

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

### RREGULLORE

#### **MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR SHQYRTIMIN E ANKIMEVE KUNDËR VENDIMEVE TË KRYEINSPEKTORIT TË ISH-KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR ARKIVIMIN E ANKESËS OSE PUSHIMIN E HETIMIT NDAJ NJË GJYQTARI**

Kjo Rregullore bazohet në nenin 62, 63, 63, 72, 73, 74, 75 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", në nenet 117, 118, 119, 120, 121, 122, 123 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit nr. 31, datë 14.02.2019 "Mbi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari",

#### **Neni 1**

##### **Objekti**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Kryeinspektorit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

#### **Neni 2**

##### **Parime të përgjithshme**

1. Parimet kryesore mbi bazën e të cilave zhvillon veprimtarinë Komisioni janë: ligjshmëria, transparenca, profesionalizmi, përgjegjësia, pavarësia, integriteti, paanësia, mos diskriminimi, konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave.

Ministria e Drejtësisë,  
Bolevardi "Zogu I"  
Tiranë, Shqipëri  
Tel: +355 4 22 40 333  
E-mail: info@euralius.eu  
Web: www.euralius.eu



### **Neni 3**

#### **Fusha e veprimtarisë së komisionit**

1. Komisioni shqyrton të gjitha ankimet kundër vendimit të ish Kryeinspektorit të K.L.D.-së, për arkivimin e ankesës, pushimi e hetimit dhe për mbylljen e hetimit ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit, të depozituara pranë institucionit, parashikuar kjo në vendimin nr. 31 datë 14.02.2019 të Këshillit.
2. Shqyrtimi i ankimeve nga Komisioni do të bëhet sipas radhës duke marrë parasysh datën e regjistrimit të tyre në regjistrin e protokollit.

### **Neni 4**

#### **Organizimi dhe funksionimi i Komisionit**

1. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë, dhe një anëtar zëvendësues të zgjedhur me short nga Këshilli. Komisioni zgjedh kryetarin në mbledhjen e tij të pare.
2. Ankesat të cilat janë të depozituara ne protokollin e Këshillit shpërndahen me short, mes anëtareve, i cili përcakton anëtarin që është relator i dosjes përkatëse. Shpërndarja bëhet në prani të të gjithë anëtarëve.
3. Shpërndarja e ankesave me short bëhet sipas rregullave të hollësishme të përcaktuara në vendimin nr.31, datë 14.02.2019 “Mbi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.
4. Komisioni asistohet në veprimtarinë e tij nga stafi administrativ.
5. Anëtari relator, përgatit relacion informues për ankimin dhe e shpërndan anëtarëve të tjerë të Komisionit së bashku me propozimin përkatës.

### **Neni 5**

#### **Konflikti i interesit**

1. Anëtari i komisionit, i pranishëm në mbledhjen e komisionit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër, lidhur me një çështje të rendit të ditës, në përputhje me nenin 72, 73, 74, 75 të ligjit nr. 115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është i detyruar përsa mëposhtë:
  - a. Të deklarojë natyrën e interesit ose pengesës;
  - b. Të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse;
  - c. Të mos marrë pjesë në votimin e çështjes përkatëse.
2. Në rastin kur një nga anëtarët e komisionit heq dore nga pjesëmarrja në mbledhje të komisionit për shkak të konfliktit të interesit, në mbledhje të komisionit futet anëtari zëvendësues. Në çdo rast një anëtar i këtij komisioni që është gjyqtar zëvendësohet po nga një anëtar tjetër gjyqtar dhe një anëtar jo gjyqtar zëvendësohet nga një anëtar tjetër jo gjyqtar.

## **Neni 6**

### **Kryetari i Komisionit**

Kryetari i Komisionit kryen këto detyra:

- a. merr masat e nevojshme për të siguruar funksionimin efektiv të Komisionit;
- b. thërret mbledhjen e Komisionit;
- c. koordinon dhe mbikëqyr aktivitetin e Komisionit;
- d. garanton ndarjen me short të ankimeve për secilin anëtarë, përfshirë dhe veten e tij;
- e. informon Këshillin lidhur me ecurinë e veprimtarisë së Komisionit;
- f. përgatit dhe prezanton raportin përfundimtar, para Këshillit, në përfundim të shqyrtimit të të gjithë ankimeve objekt i këtij komisioni.

## **Neni 7**

### **Mbledhjet e Komisionit**

1. Komisioni mblidhet sa herë është e nevojshme, nga Kryetari, duke caktuar rendin e ditës, datën dhe orën e saj, si dhe vendin e organizimit të saj. Thërritja e mbledhjes mund të kërkohet edhe nga një anëtar i Komisionit. Kur thërritja e mbledhjes kërkohet nga të dy anëtarët e tjerë Kryetari e ka të detyruar thirrjen e saj.
2. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë të 3 anëtarët e Komisionit.

## **Neni 8**

### **Shqyrtimi i ankimit në komision**

1. Komisioni, pas parashtrimit të relacionit të relatorit, lidhur me ankimin, verifikon nëse arkivimi i ankesës nga Kryeinspektori është bërë në përputhje me nenin 120 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në RSH” që përcakton se kriteret për pranueshmërinë e ankesës janë:
  - a. paraqitet në formë të shkruar dhe përmban të dhënat e mëposhtme:
    - a. gjenealogjet dhe adresën e ankuesit, si dhe nëse ankuesi kërkon konfidencialitetin e identitetit të tij; përshkrim të rrethanave të faktit që pretendohen të kenë ndodhur;
    - b. emrin dhe mbiemrin e magjistratit, gjykatën ose prokurorinë, në të cilën magjistrati ka ushtruar funksionin në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar;
    - c. i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor;
    - d. nuk përmban elemente abuzive, nuk është haptazi e pabazuar ose e përsëritur nga i njëjti ankues;
    - e. bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, i cili ka qenë në detyrë në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;
    - f. bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, të parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;
    - g. bëhet ndaj sjelljes së magjistratit që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.

2. Nëse ankimi kundër vendimit të Kryeinspektorit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për arkivimin e ankesës, dhe për mbylljen e hetimit ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit, është paraqitur jashtë afatit ligjor, që parashikon neni 121 paragrafi 3 dhe neni 122 paragrafi 5 të ligjit 115/2016, Komisioni vendos mospranimin e ankimit për këtë shkak.
3. Komisioni ka të drejtë të kërkojë çdo dokumentacion i cili konsiderohet i nevojshëm dhe ndihmës për veprimtarinë e tij sipas ligjit.
4. Kryetari i Komisionit është përgjegjës për të siguruar që administrata të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që çdo mbledhje e Komisionit të dokumentohet në mënyrë të përshtatshme përmes procesverbalit me përmbledhjen e diskutimeve dhe nëse është e mundur nëpërmjet sistemit audio. Procesverbali duhet të përmbajë nënshkrimin e përpiluesit dhe të anëtarëve të komisionit në fund të çdo faqeje.
5. Procesverbali i mbledhjeve të Komisionit, depozitohet në arkiv dhe do të jetë pjesë e dosjes së akteve të Komisionit

#### **Neni 9**

##### **Vendimet e Komisionit**

1. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit, siç është rënë dakord.
2. Vendimi i komisionit është përfundimtar dhe nuk mund të apelohej para mbledhjes plenare të Këshillit.
3. Komisioni me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm vendos miratimin e tij. Kryetari i Komisionit voton i fundit.
4. Në rastin kur Komisioni i Përkohshëm pranon ankimin, pra rrëzon vendimin e dhënë nga Kryeinspektori i ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, njoftohen palët dhe çështja regjistrohet në një regjistër të veçantë të krijuar për këtë qëllim, në pritje për t'i kaluar për hetime të mëtejshme Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, menjëherë sapo ai të ngrihet si institucion.
5. Vendimi i Komisionit hartohet nga anëtari relator përgjegjës për ankimin, dhe zbardhet në 4 kopje.

#### **Neni 10**

##### **Komunikimi**

Komisioni pas shqyrtimit të ankimit, në përfundim të procesit, vendimmarrjen në lidhje me të, duhet t'ia njoftojë ankuesit, magjistratit dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.

#### **Neni 11**

##### **Kohëzgjatja e veprimtarisë së komisionit**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së komisionit duhet të jetë deri në shqyrtimin e të gjitha praktikave lidhur me ankimet kundër vendimit të Kryeinspektorit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.